



Datë: 25.09.2025

Numër Protokolli: 6453/2025

A.nr.1488/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave nga: Malsore Gashi-Bajraktari-kryetare, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtar, me Atdhe Gashi-në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës ankesën A.nr.1488/2024 të datës 28.07.2025, të parashtruar nga ankuesi B.A, kundër organit të punësimit: Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve, në çështjen juridike “*kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 25.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.1488/2025, të datës 28.07.2025, të parashtruar nga ankuesi, B.A.

A r s y e t i m

Ankuesi, B.A (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesi), më datë 28.07.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00018126, të shpallur me datë 02.07.2025, nga Komisioni Qendrorë i Zgjedhjeve për pesëmbëdhjetë (15) pozitat e punës “*Zyrtar Administrativ në KKZ*”.

Ndërsa, ankuesi më datë 24.09.2025, përmes shkresës me numër protokolli 6326/2025, ka tërhequr ankesën e datës 28.07.2025, të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Kolegji i Këshillit duke marr për bazë kërkesën e datës 24.09.2025, të ankuesit për tërheqje nga ankesa A.nr.1488/2025 e datës 28.07.2025, konstatoi plotësimin e kushtit ligjor për përfundimin e procedimit administrativ, siç parashihet me dispozitat e nenit 103 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “*Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë*”, dhe si rrjedhojë në mbështetje të nenit 18, paragrafit 1, nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi për përfundimin e procedimit administrative të filluar sipas ankesës me numër A.nr.1488/2025 të datës 28.07.2025, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1488/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit B.A;
- Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Komisionin Qendrorë të Zgjedhjeve; si dhe,
- Arkivit të KPMSHCK-së.